



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 2687 prot.

Tiranë, më 01 . 04 .2025

Lënda: Vendim për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1596, datë 19.11.2012.

SHOQËRISË “FAFA KONSTRUKSION” SH.P.K

Bulevardi Blu, Zona kadastrale Nr. 8320, Nr. Pasurie 1/138-ND, Kamëz, Tiranë

Për dijeni: QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Bulevardi “Zhan D’ark, Pranë Ministrisë së Jashtme”, Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE

Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “FAFA KONSTRUKSION” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin “Zall Gjoçaj, Derjan”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër. Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 5513, datë 13.12.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 9784 Prot., datë 16.12.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin “Zall Gjoçaj, Derjan”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, pasi në objekt nuk zhvillohet aktivitet minierar prej më shumë se një viti.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në përputhje me nenin Nr. 48 të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me shkresën tonë Nr. 9784/1, datë 31.12.2024, **jeni njoftuar se ka filluar procedura e revokimit të Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin “Zall Gjoçaj, Derjan”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.**

Sa më sipër, në zbatim të nenit Nr.48, pika 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë vendimin e revokimit të Lejes Minerare të Shfrytëzimit Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin “Zall Gjoçaj, Derjan”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.** Kundër këtij vendimi bëhet ankim në Gjykatën Administrative, sipas legjislacionit në fuqi. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

CENO KLOSI

